



**REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA
KOMUNA VUSHTRRI – OPSTINA VUCITRN**

**Drejtoria për Prokurim Publik
14 Nr. 434/24
Daët 11.07.2024**

Duke vendosur në çështjen administrative, sipas Kërkesës për Rishqyrtim të subjektit në procedurë: **“A&E Group” Sh.p.k. me seli në Prishtinë**, Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, pas mbajtjes të seancës jo publike të shqyrtimit të kërkesës në fjalë, në bazë të nenit 108/A pika 6 lidhur me pikën 10 paragrafi 10.1 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092, me datën 11.07.2024, merr këtë:

VENDIM

1. Refuzohet si e pabazë Kërkesa për rishqyrtim e subjektit në procedurë : **“A&E Group” Sh.p.k. me seli në Prishtinë** lidhur me kriteret kualifikuese të vendosura në dosjen e tenderit dhe njoftimit për kontratë në aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e objekteve të AK”**, me numër prokurimi: **VU644-24-6249-2-1-1**, inicuar nga AK – Komuna e Vushtrrisë.
2. Vërtetohet Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit e datës 01.07.2024 lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e objekteve të AK”**, me numër prokurimi: **VU644-24-6249-2-1-1**, andaj AK – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë vazhdon më tutje me procedurën e prokurimit.

A r s y e t i m

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë (në tekstin e mëtejme A.K.) në bazë të kërkesës së Njësisë Kërkuese ka inicuar aktivitetin e prokurimit me titull: **“Mirëmbajtja e objekteve të AK”**, me numër prokurimi: **VU644-24-6249-2-1-1**.

Më 05 korrik 2024, Autoriteti Kontraktues përmes platformës e-prokurimi ka pranuar Kërkesën për Rishqyrtim të parashtruar nga operatori ekonomik **“A&E Group” Sh.p.k.** kundër njoftimit për kontratë dhe dosjes së tenderit lidhur me aktivitetin e prokurimit **“Mirëmbajtja e objekteve të AK”**, me numër prokurimi: **VU644-24-6249-2-1-1**. Në arsyetimin e Kërkesës për rishqyrtim, OE **“A&E Group” Sh.p.k.** (në tekstin e mëtejme Ankuesi) pretendon se, A.K. duke vendosur kërkesa diskriminuese në dosjen e tenderit ka shkelur dispozitat e LPP-së, konkretisht: nenin 1 – Qëllimi, nenin 7 – Barazia në trajtim/Ko Diskriminimi, nenin 56 – Dispozitat e përgjithshme

për zgjedhjen e pjesëmarrësve dhe dhënien e kontratave, nenin 60 – Kriteret për dhënie të kontratësi dhe nenin 69 – Aftësitë teknike/profesionale. Andaj si pasojë e kësaj ankese, AK e ka pezulluar procedurën e prokurimit ashtu siç e obligon neni 108/A paragrafi 2 i LPP-së.

Autoriteti Kontraktues – Drejtoria Komunale për Prokurim Publik e Komunës së Vushtrrisë, gjatë fazës së shqyrtimit paraprak ka konstatuar se ankesa i përmban elementet e përcaktuara përmes nenit 60 paragrafi 3 të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik dhe si e tillë është parashtruar brenda afatit ligjor në përputhje me nenin 108/A paragrafin 3.1 të LPP në procedurë paraprake për zgjidhje të mosmarrëveshjeve nga operatori ekonomik që është palë e interesuar sipas nenit 4 paragrafit 1 nën-paragrafit 26 të LPP. Në këtë mënyrë AK ka konstatuar se është kompetent për të shqyrtuar këtë kërkesë sipas nenit 108/A të LPP lidhur me nenin 63 të RRPP dhe nuk ekziston asnjë pengesë procedurale për të vazhduar me shqyrtimin e saj në mënyrë meritore.

Autoriteti Kontraktues, pasi shqyrtoi një nga një pretendimet e OE ankues të parashtruara në Kërkesën për Rishqyrtim në kontekstin e përgjithshëm të kërkesave dhe kushteve të zbatueshme të dosjes së tenderit/njoftimit për kontratë, fakteve të pohuara nga OE ankues, duke pasur parasysh natyrën dhe qëllimin e aktivitetit të prokurimit dhe duke u mbështetur në LPP dhe RRPP, **gjeti se kërkesa për rishqyrtim është e pabazë.**

1. Pretendimi i parë: OE ankues pretendon se është e pakuptimtë kërkesa që diplomat/certifikatat të jenë të noterizuara nga vet personi e veçmas duke ju referuar kërkesës në pikën f) për punëtorët teknik, me arsyetimin se, sipas pohimeve të ankuesit kjo është humbje kohe dhe shpenzim i tepërt financiar. Andaj ka kërkuar që kjo kërkesë të hiqet nga dosja e tenderit duke rekomanduar që të verifikohet gjatë vlerësimit duke kërkuar origjinalin në rast të dyshimit.

Përgjigja e AK-së: Lidhur me këtë pretendim, A.K. konstaton se është i pabazë pasi që OE ankues nuk ka arritur t'a argumentojë me asnjë fakt dhe provë se kjo kërkesë e kufizon ose ulë konkurrencën e lirë në treg dhe e diskriminon atë në këtë aktivitet të prokurimit. Kjo kërkesë e kualifikimit lidhur me kapacitetet profesionale/teknike që operatorët ekonomik duhet t'i angazhojnë në funksion të këtij aktiviteti të prokurimit, i përmban njëmbëdhjetë pika të evidentuara nga shkronja a) deri te shkronja gj). Prej tyre është kërkuar të paraqiten dokumente të noterizuara (standard që aplikohet nga shumica e AK-ve) vetëm për tri pika, konkretisht në pikat me shkronjën e) dhe ë) kërkohet diploma e noterizuar (noterizimi te prezantohet nga vete teknikët te noteri) dhe për pikën me shkronjën f) kërkohet certifikata e noterizuar (noterizimi të prezantohet nga vetë personi i certifikuar te noteri). Kërkesa për noterizimin e dokumenteve është një praktikë/standardt i zakonshëm nga të gjithë AK në mënyrë që të garantohet autenciteti i dokumenteve dhe të dhënave të paraqitura në procese të prokurimit, por jo vetëm, duke shmangur rastet kur paraqitetn dokumente të pavlefshme të personave që aktualisht nuk janë të punësuar/angazhuar në kompaninë përkatëse.

Kjo masë rrit transparencën dhe besueshmërinë e procesit të tenderimit, duke siguruar që të gjithë operatorët ekonomik të konkurojnë në kushte të barabarta. Gjithashtu, kostot e noterizimit janë të njejta për të gjithë operatorët ekonomik dhe nuk vendosin asnjë operatorë në pozitë diskriminuese apo favorizuese. Përkundrazi, kjo kërkesë është e nevojshme, relevante dhe proporcionale në raport me objektin, natyrën dhe vëllimin e punëve të parapara në këtë aktivitet dhe si e tillë mbetet në fuqi pasi që siguron konkurrencë të barabartë sipas nenit 7 të LPP-së për të gjithë OE që dëshirojnë të marrin pjesë në këtë aktivitet.

2. Pretendimi i dytë: OE ankues pretendon se është e pakjartë kërkesa sa i përket numrit për armirues, latues, etj, me arsyetimin se sipas formulimit të përgjithshëm të kërkesës është përcaktuar “*së paku një prej secilit profil*” e ndërsa tek kërkesa specifike janë kërkuar nga dy armirues, latues, etj. Tutje ankuesi pretendon se kërkesa që stafi në fjalë

të jetë i çertifikuar nga një institucion i licencuar në Republikën e Kosovës është kërkesë diskriminuese për të dhe favorizuese për OE të caktuar, me arsyetimin se, shkollimi/çertifikimi i këtyre individëve ka vite që është bërë në vende tjera dhe se kinse punëtorët e OE ankues kanë punuar qe shumë vite me këto profesione që janë çertifikuar jashtë vendit.

Përgjigja e AK-së: Lidhur me këtë pretendim, A.K. konstaton se është i pabazë pasi që OE ankues nuk ka arritur t'a argumentojë me asnjë fakt dhe provë se kjo kërkesë e kufizon ose ulë konkurrencën e lirë në treg dhe e diskriminon atë në këtë aktivitet të prokurimit. Sa i përket çështjes lidhur me punëtorët e profileve të ndryshme, përkatësisht përshkrimit të përgjithshëm ku është shënuar "*së paku nga një për secilin profil*" dhe përshkrimit specifik ku për secilin profil është kërkuar të prezentohen nga dy punëtorë të çertifikuar, përkatësisht "*dy armirues, dy latues, dy murator, dy suvatues, dy molera, dy shtrues pllakash, dy instalues për instalime elektrike, dy instalues për ujësjellës dhe kanalizim*", e sqarojmë se formulimi i shënuar "*së paku nga një për secilin profil*" është gabim teknik gjatë përpilimit të DT dhe nuk e pasqyron qëllimin e saktë të kërkesës. Kërkesa e saktë është në përputhje me përshkrimet e formulimeve specifike për secilin profil, përkatësisht dy punëtorë për secilin profil, pasi që si e tillë është bërë për të siguruar që OE të kenë burime të mjaftueshme njerëzore të kualifikuara në profilet e lartcekura për të përmbushur detyrimet e kontratës në mënyrë efikase dhe të sigurtë. Prandaj operatorët ekonomik duhet t'i referohen në përshkrimet specifike të kërkesave për secilin profil, siç janë paraqitur në dosjen e tenderit dhe sqaruar më sipër.

Sa i përket kërkesës që punëtorët e profileve të ndryshme, të jenë të çertifikuar nga një Institucion i licencuar i Republikës së Kosovës, e theksojmë se kjo kërkesë në tërësinë e saj është relevante dhe proporcionale në raport me objektin, natyrën, dhe vëllimin e punëve të parapara në këtë aktivitet. Nisur nga fakti se të gjitha këto kualifikime të çertifikimit të personave me profile të lartcekura për më shumë se një dekadë janë të pranishme me numër solid ose të mjaftueshëm në tregun e punës në Kosovë të çertifikuar nga qendra të aftësimit profesional dhe institucione tjera të licencuara në Republikën e Kosovës. Konkretisht Qeveria e Kosovës përmes Ministrisë së Financave, Punës dhe Transfereve (ish Ministrisë së Punës dhe Mirëqenies Sociale) menaxhon tetë (8) Qendra të Aftësimit Profesional (QAP), në shtatë (7) regjionet e Republikës së Kosovës: Prishtinë, Prizren, Pejë, Gjakovë, Ferizaj, Gjilan dhe Mitrovicë që ofrojnë trajnime dhe çertifikime falas në profesione të caktuara. Gjithashtu Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve në vazhdimësi ka akredituar institucione të licencuara që ofrojnë program të standardeve të aftësimit profesional për individ të interesuar që pas procesit të vlerësimit çertifikohen me kualifikimin profesional në profilin e caktuar, ku përfshihen të gjitha profilet që janë specifikuar në kërkesën e dosjes së tenderit (shih listën e standardeve profesionale të aprovuara dhe listën e institucioneve të akredituara nga AKK në ëeb faqen e saj). Në këtë kontekst, theksojmë se kërkesa për çertifikata të lëshuara nga institucionet e licencuara në Kosovë është e justifikueshme dhe e nevojshme për të siguruar dhe mbrojtur cilësinë në realizimin e projektit në fjalë dhe nga ana tjetër për të garantuar përputhshmërinë e kualifikimeve të fituara me standardet kombëtare nga autoritetet e licencuara kosovare. Andaj sipas sqarimeve të lartcekura e theksojmë se kjo kërkesë nuk eliminon konkurrencën në mesin e OE, rrjedhimisht nuk është diskriminuese apo favorizuese për njërin apo palën tjetër, sepse është e drejtuar drejt sigurimit të qasjes sa më të mirë dhe zbatohet në kushte të barabarta dhe njësoj për të gjithë operatorët ekonomik të interesuar për pjesëmarrje në këtë aktivitet.

3. Pretendimi i tretë: OE ankues pretendon se, kërkesa e specifikuar në pikën me shkronjën g) ku përcaktohet se "*OE duhet të ofroj dëshmi se posedon iso standardë ISO DS CEN/TR 15128 2005 një person për drenazhim të dheut*" është kërkesë diskriminuese për të dhe favorizuese për OE që merren vetëm me drenazhime, me arsyetimin se ka shumë pak pozicione që kanë të bëjnë me drenazhimin.

Përgjigja e AK-së: Lidhur me këtë pretendim, A.K. konstaton se është i pabazë pasi që OE ankues nuk ka arritur t'a argumentojë me asnjë fakt dhe provë se kjo kërkesë e kufizon ose ulë konkurrencën e lirë në treg dhe e diskriminon atë në këtë aktivitet të prokurimit. Ngase kjo kërkesa janë të nevojshme, relevante dhe proporcionale në raport me objektin, natyrën, fushëveprimin dhe vëllimin e punëve të parapara në këtë aktivitet. Sa i përket kërkesës me standardin e përputhshmërisë ISO DS CEN/TR 15128 2005, A.K. sqaron se, është një standard ndërkombëtar i njohur dhe pranuar gjerësisht që në thelb përfshinë garantimin e një kornize të qartë të kontrollit të cilësisë që përfshinë kërkesat dhe udhëzimet për aplikimin e metodave dhe mjeteve të nevojshme për kontrollin e nivelit të kërkuar të cilësisë dhe sigurisë duke përfshirë edhe materialet e përdorura në projektet e ndërtimit dhe inxhinierisë civile. Nga ana tjetër parandalon dhe minimizon rrezikun e defekteve ose gabimeve në fazat e ndryshme gjatë realizimit të projektit, rrjedhimisht ndihmon në rritjen e efikasitetit dhe performancën e përgjithshme të projektit në përputhje me standardet ndërkombëtare.

Në rrethanat konkrete, kërkesa me standardin ISO DS CEN/TR 15128 2005 një person për drenazhim të dheut është lehtësisht e disponueshme për t'u siguruar përmes faqeve të organizatave apo institucioneve kombëtare ose ndërkombëtare që ofrojnë trajnime dhe certifikime me standardet ISO përfshirë edhe standardin ISO DS CEN/TR 15128 2005. Andaj duke ju përshtatur rëndësisë së projektit dhe aspekteve dhe specifikave të sqaruara më lartë është kërkuar një kërkesë e tillë e cila mundëson standarde të kontrollit të cilësisë që janë të përshtatshme dhe justifikueshme me natyrën dhe objektin e këtij projekti.

4. Pretendimi i katërt: OE ankues kërkon që të ndryshohet kërkesa specifikuar në pikën me shkronjën gj) ku përcaktohet se “*Nje person te Certifikuar me ISO 9001:2008 dhe 18001:2007*” duke rekomanduar që një person të jetë i certifikuar me ISO 9001 dhe një person tjetër me ISO 18001 me arsyetimin se ka shumë pak persona që janë të certifikuar me të dy ISO-t e lartcekura.

Përgjigja e AK-së: Lidhur me këtë pretendim, A.K. konstaton se është i pabazë pasi që OE ankues nuk ka arritur t'a argumentojë me asnjë fakt dhe provë se kjo kërkesë e kufizon ose ulë konkurrencën e lirë në treg dhe e diskriminon atë në këtë aktivitet të prokurimit. Ngase kërkesa për ISO 9001:2008 dhe 18001:2007 për një person janë të arsyeshme dhe relevante për një kompani të qëndrueshme dhe profesionale që ka një strategji dhe qëllim të qartë për integrimin e sistemit të menaxhimit të cilësisë dhe menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë. Gjithashtu këto dy standarde ISO për një person janë të ndërlidhura në kontekstin e përgjithshëm për të mënaxhuar cilësinë dhe sigurinë mënyrë të integruar, që është e rëndësishme për menaxhimin efektiv të riskut dhe rritjen e përgjithshme të performancës organizative në të gjitha proceset e zbatimit të sistemit të menaxhimit. Në këtë kontekst, certifikatat me programe për standardin ISO 9001:2008 dhe 18001:2007 janë lehtësisht e disponueshme për t'u siguruar përmes faqeve të organizatave apo institucioneve kombëtare ose ndërkombëtare dhe faqeve të internetit të akredituara, që ofrojnë programe trajnime dhe mbështetje me standardet e certifikimit ISO 9001:2008 dhe 18001:2007. Andaj është kërkuar një kërkesë e tillë e cila mundëson një menaxhim efektiv të kontrollit të cilësisë dhe menaxhimin e shëndetit dhe sigurisë në punë që janë të përshtatshme dhe justifikueshme me natyrën dhe objektin e këtij projekti.

5. Pretendimi i pestë: OE ankues pretendon se, kërkesa e specifikuar në listën e pajisjeve, konkretisht të përshkrimi i pajisjeve me numrat rendor 6, 11, 12, 17, 0, 21 dhe 22, është e specifikuar ngushtë dhe është diskriminuese për të si OE.

Përgjigja e AK-së: Lidhur me këtë pretendim, A.K. konstaton se, përveç faktit se i njëjti është i paqartë, gjithashtu është i pabazë dhe i pa argumentuar me asnjë fakt dhe provë konkrete se pse kjo kërkesë e diskriminon OE ankues apo e kufizon ose ulë konkurrencën e lirë në treg. Në rrethanat e rastit konkret, e theksojmë se mjetet, stabilimentet dhe pajisjet teknike të

obligueshme sipas Aneksit 7 të DT janë përcaktuar dhe specifikuar duke ju përshtatur funksionit të realizimit me sukses të kontratës dhe njëkohësisht në raport me domosdoshmërinë dhe relevancën e ngushtë me lëndën e kësaj kontrate si dhe duke u bazuar në rrethanat e përgjithshme dhe të veçanta objektive për zhvillimin e punimeve duke marrë parasysh kufijtë e lejuar të legjislacionit të prokurimit publik dhe në funksion të qëllimit dhe parimeve të këtij ligji. Në këtë kontekst e sqarojmë se pajisjet dhe mekanizimi i obligueshëm që është kërkuar në dosjen e tenderit dhe është kontestuar nga ana e OE ankues, sigurojnë nivel të konkurrencës sa më të madhe dhe të barabartë për të gjithë OE që dëshirojnë të aplikojnë në këtë aktivitet prokurimi, ngase është ofruar hapësirë e mjaftueshme e përzgjedhjes duke e përcaktuar minimumin dhe maksimumin e peshës/tonazhës dhe çfarëdo specifike tjetër për secilën pajisje varësisht funksionit ose qëllimit të përdorimit të saj në funksion të realizimit të projektit. Andaj për sa i takon këtij pretendimi, A.K. konsideron se kërkesa në fjalë është në pajtueshmëri me nenet 7, 51 paragrafi 2 dhe 3 dhe 69 paragrafi 1 dhe 4.5 të LPP-së.

6. Sa i përket pretendimeve tjera të ngritura në kërkesë lidhur me pohimet me formulime të ekzagjeruara e me supozime kinse për shkelje të neneve: 1, 7, 56, 60, 69 të LPP-së, A.K. thekson se të njejtat janë të pabaza dhe të pa argumentuara me asnjë fakt dhe provë konkrete, por si të tilla janë në kundërshtim me bazën faktike dhe ligjore.

Sa i përket pohimeve të ngritura se kinse dosja e tenderit përmban kërkesa diskriminuese dhe kufizuese në kundërshtim me nenin 1, 7, 56 dhe 69 të LPP-së, A.K. konstaton se arsyet e pohuara janë supozime të pabaza pasi që nuk kanë mbështetje në fakte konkrete dhe argumente bindëse. Për shkak se procedura për hartimin e kërkesave, termeve, kushteve materiale dhe informatave tjera përkatëse të dosjes së tenderit është përpiluar duke u bazuar në aplikimin e dispozitave përkatëse të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin nr. 04/L-237, Ligjin nr. 05/L-068 dhe Ligjin Nr. 05/L-092 si dhe pjesës përbërëse e legjislacionit dytësor për prokurim publik, RRPP nr. 001/2002 dhe UPP nr. 001/2023. Njoftimi për Kontratë dhe Dosja e Tenderit me të gjitha informatat relevante për kontratën në fjalë që përfshijnë të gjitha specifikimet, kërkesat, kriteret, afatet kohore, kushtet e kontratës, procedurat e zbatueshme të prokurimit dhe çfarëdo kërkesë tjetër përkatëse, është e hartuar në mënyrë proporcionale në raport me objektin, natyrën dhe vëllimin e punëve të parapara në këtë aktivitet sipas nenit 17 të Rregullorës Nr. 001/2022 për Prokurimin Publik, nenit 28 të LPP-së, duke pasë në konsideratë qëllimin e këtij ligji si dhe duke siguruar konkurrencë të lirë e sa më të madhe të mundur për të gjithë OE që shprehin interesim të marrin pjesë në këtë aktivitet, duke mos e dëmtuar apo ulur cilësinë e shërbimeve dhe punimeve të kërkuara.

Sa i përket pohimeve të ngritura kinse për shkelje të nenit 60 të LPP-së, A.K. thekson se ky pohim është paragjykues, pasi që në kontekstin e rrethanave konkrete kjo dispozitë nuk ka të bëjë me çështjen konkrete, respektivisht nuk është e aplikueshme ose nuk ndërliiden në situatën dhe procedurën e tanishme të këtij aktiviteti të prokurimit.

Nga konteksti i lartëcekur, A.K. i rikujton OE ankues se kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë A.K. për njohjen e kapaciteteve minimale të OE, të cilët nëpërmjet dokumentacionit duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme të kapaciteteve ekonomike, financiare, teknike, profesionale, përvojën e duhur, personelin e nevojshëm dhe gjithçka tjetër në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Në fund, A.K. thekson se vërtetohen dhe mbesin në fuqi të gjitha kërkesat, kushtet materiale dhe informatat tjera përkatëse të dosjes së tenderit sipas versionit të korrigjuar, për arsye se të njejtat garantojnë transparencë dhe konkurrencë të drejtë e të barabartë sipas praktikave më të mira për të gjithë OE që zotërojnë kapacitetet e nevojshme të lartcekura në funksion të

realizimit me sukses të kontratës në raport me objektin dhe specifikat e fushëveprimtarisë së saj.

Nga se u tha më lartë, e në pajtim me dispozitat e lartcekura, A.K. vlerëson se nuk ka asnjë arsye të vensosë ndryshe nga ajo që është theksuar si më lartë, andaj edhe është vendosur si në dispozitiv të këtij vendimi.



Drejtoria për Prokurim Publik


Ilmi Azemi

Këshillë juridike: Pala e pakënaqur me këtë Vendim ka të drjtë të parashtroi Ankesë pranë Organit Shqyrtues për Prokurim – OSHP-së, në pajtim me nenin 109 të Ligjit Nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092.

Nga një kopje i dërgohet:

1x1 Palës/ ve;
1x1 DPP, dhe
1x1 Arkivit.